



FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

Buletin i FKGK-së

EDICIONI I PESTË | Tetor 2022

FINANCIMI I AGROBIZNESEVE NË KOSOVË



DONATORËT



QEVERIA E KOSOVËS



AGJENCIA AMERIKANE PËR
ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR
(USAID)



BANKA GJERMANE PËR ZHVILLIM
(KfW)

BASHKËPUNËTORËT




AGJENCIA SUEDEZE PËR ZHVILLIM DHE
BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (SIDA)



FONDACIONI KOSOVAR I MILENIUMIT (MFK)



BANKA BOTËRORE (BB)



FONDI EVROPIAN I INVESTIMEVE (EIF)

INSTITUCIONET FINANCIARE PARTNERE



Të nderuar lexues,

Kemi kënaqësinë që të prezantojmë edicionin e pestë të buletinit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë! Buletini ka një mision të thjeshtë – të informojë publikun për punën, iniciativat dhe aktivitetet tona.

Ky edicion i është dedikuar sektorit AGRO dhe jemi munduar që të sjellim artikuj sa më relevant nga njerëz kompetent të fushës dhe akterët kyç në spektrin e gjerë të AGROs.

Gjithashtu, në këtë edicion i kemi sjellë të arriturat e FKGK deri në tremujorin e tretë si dhe aktivitetet e shumta deri më 30 shtator 2022.

Falenderojmë të gjithë për kontributin e dhënë përmes opinioneve dhe shkrimeve, që e kanë pasuruar buletin tonë.

Lexim të këndshëm!

PËRMBAJTJA

- | | | | |
|----|--|----|--|
| 04 | PARATHËNIE
MELIH CADIRCI
Anëtar i Pavarur i Bordit të FKGK-së | 18 | JAVA E FONDIT
FKGK prezantohet në intervistën e INDEP |
| 06 | OPINIONE
Sektori i bujqësisë në Kosovë - MBPZHR | 18 | FKGK pjesë e buletinit të Këshillit të Investitorëve Evropianë - EIC |
| 10 | OPINIONE
Financimi i sektorit të bujqësisë përmes Bankës Ekonomike | 18 | Lansohet Dritarja GROW |
| 13 | OPINIONE
Kreditimi në bujqësi si prioritet i KEP Trust | 19 | FKGK publikon dokumentarin për Start-Up |
| 16 | STORIE SUKSESI
VE-TRO-ISOL AG - Go Healthy | 19 | FKGK pjesë e forumit të solarëve 2022 |
| 17 | KËNDI I LAJMEVE 2022 | 19 | FKGK publikon Raportin Vjetor 2021 |
| 17 | FKGK shënon gjashtë vjetorin e themelimit - | 20 | Nënshkruhet memorandumi i mirëkuptimit për Dritaren e Eksportit |
| | | 20 | Delegacioni i FKGK-SË në takimin e përgjithshëm të AEEM-së |

Opinionet, mendimet dhe analizat e shprehura përmes artikujve të botuar nuk reflektojnë domosdoshmërisht qëndrimet e FKGK-së apo qasjen e Institucionit ndaj të njejtave.

PARATHËNIE

Të nderuar lexues,

Jam i nderuar që po e shkruaj parathënien për edicionin e ri të buletinit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, që kësaj radhe, pra në këtë edicion, kemi vendosur të flasim për kreditë për bujqësi, i cili është çelës për zhvillimin e fermerëve dhe këtij sektori në përgjithësi.

Ushqimi është nevojë bazike dhe bujqësia është njëra nga burimet e ushqimit tonë. Duke ofruar ushqimin, bujqësia është gurthemel i ekzistencës njerëzore. Jeta e njerëzve nuk mund të imagjinohet pa bujqësi. Por, bujqësia nuk na jep vetëm ushqimin, por njëkohësisht luan një rol të rëndësishëm në ekonomi: është burim kryesor i lëndës së parë; është akter kyç në të ardhurat/të hyrat e vendit, si dhe tregtinë ndërkombëtare. Bujqësia siguron punësim, gjeneron vende të reja të punës që përfshijnë të gjitha industritë.

Duke qenë e ndërlidhur pothuajse me secilin sektor të ekonomisë, shumë lehtë mund të themi që bujqësia e zhvilluar është zhvillim i ekonomisë. Prandaj, mekanizmat e veçantë që e mbështesin bujqësinë duhet të lehtësohen nga qeveritë. Në këtë kontekst, kreditë për bujqësi kanë rëndësi të veçantë. Kreditë i ndihmojnë fermerët t'i kryejnë në kohë aktivitetet bujqësore, si dhe të përmirësojnë dhe zgjerojnë bizneset e tyre kur kapitali i tyre është i kufizuar. Përveç kredive, instrumentet e lizingut ofrojnë përfitime të ngjashme për fermerët. Duke e ditur rëndësinë e bujqësisë dhe duke qenë sektor i pashërbyer për sa i përket kredive bankare, Fondi Kosovar për Garanci të Kredive (FKGK) ka lansuar një dritare garancie për kredi me ndihmën e Qeverisë Gjermane - përmes Bankës Zhvillimore KfW - për të nxitur kreditimin bujqësor në Kosovë.



MELIH CADIRCI

Anëtar i pavarur i Bordit - FKGK



Jeta e njerëzve nuk mund të imagjinohet pa bujqësi. Por, bujqësia nuk na jep vetëm ushqimin, por njëkohësisht luan një rol të rëndësishëm në ekonomi: është burim kryesor i lëndës së parë; është akter kyç në të ardhurat/të hyrat e vendit, si dhe tregtinë ndërkombëtare.

Me këtë lehtësi, fermerët me qasje të kufizuar në financa, për shkak të mungesës së kolateralit do të mund të marrin kredi, për ta vazhduar dhe zgjeruar biznesin e tyre. Si një shembull shumë i mirë me qasjen e saj holistike, KCGF zhvilloi një mjet për vlerësimin e kredive dhe ju ofroi institucioneve financiare të regjistruara për shërbim.

Me këtë instrument, bankat do të mund të kuptojnë dhe menaxhojnë rreziqet e tyre reale që lidhen me kreditë për bujqësi. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ka ofruar trajnime të nevojshme për stafin e bankave (bankierët) që të sigurojnë shfrytëzimin efikas të këtij mjeti. Me këtë, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore dëshmoi se ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e sektorit financiar në Kosovë. Pjesë e qasjes së saj holistike, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore i regjistroi si partnere edhe institucionet mikrofinanciare.

Këta partnerë të rinj do të përmirësojnë shtrirjen e kredive bujqësore të mbështetura nga dritarja Agro e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore për fermerët që jetojnë në rajonet e largëta të Kosovës. Gjithashtu, një kompani e lizingut është përfshirë në institucionet e regjistruara, partnere të FKGGK-së, e cila mund ta marrë një rol aktiv të operimit të lizingut bujqësor.



Duke qenë e ndërlidhur pothuajse me secilin sektor të ekonomisë, shumë lehtë mund të themi që bujqësia e zhvilluar është zhvillim i ekonomisë.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ndërmori hapa të rëndësishëm për të mbështetur kreditimin bujqësor në Kosovë. Ne presim zhvillime të mëtejshme të portofolit, ashtu që të prezantojmë histori suksesi që kanë të bëjnë me kontributin pozitiv të garancive të FKGGK-së në sektorin e bujqësisë.

Dëshiroj t'i falenderoj të gjithë kontribuesit në këtë edicion të buletinit tonë, duke u dëshiruar lexim të këndshëm të gjithë lexuesve të buletinit të FKGGK-së. Ju lus që, t'i ndani me ne idetë dhe komentet tuaja të çmuara.



SEKTORI I BUJQËSISË NË KOSOVË

Bujqësia është një ndër sektorët kryesor që kontribuon dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Ky sektor i Kosovës ofron mundësi reale për zbutjen e varfërisë, gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe krijimin e të ardhurave për banorët e zonave rurale dhe jo vetëm.

Sektori i bujqësisë është një nga aktivitetet më të rëndësishme në vendin tonë, duke u nisur nga fakti se bujqësia kontribuon rreth 7% të GDP-së së përgjithshme të vendit, dhe vlerësohet se punëson rreth 23% të gjithsej numrit të të punësuarve në Kosovë. Si një nga aktivitetet më të rëndësishme ekonomike në vend, potenciali për zhvillimin e bujqësisë është ende i pashfrytëzuar.

Përkundër faktit që Kosova ka tokë pjellore bujqësore të cilësisë së lartë, fragmentimi i tokës, pajisjet dhe makineritë e vjetra dhe të pamjaftueshme bujqësore, infrastruktura e dobët bujqësore, inputet e shtrenjta dhe qasja e vështirë në financa po ndikon në produktivitet të ulët për njësi vjetore pune në bujqësi në krahasim me vendet e BE-së dhe vendet fqinje.

Ministra e Bujqësisë, e Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor.

Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas i resurseve natyrore, si dhe ofrim i produkteve cilësore për tregun vendor, të rajonit dhe BE-së. MBPZHR, së fundmi ka hartuar dhe publikuar Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028, strategji e cila ka për qëllim zhvillimin e sektorit agro-rural, konkurrues dhe inovativ, të bazuar në njohuri, teknologji dhe standarde moderne.



DELVINA HANA BAKIJA

Udhëheqëse e Departamentit të Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



Sektori i bujqësisë është një nga aktivitetet më të rëndësishme në vendin tonë, duke u nisur nga fakti se bujqësia kontribuon rreth 7% të GDP-së së përgjithshme të vendit, dhe vlerësohet se punëson rreth 23% të gjithsej numrit të të punësuarve në Kosovë.

Strategjia mbështetet në 4 (katër) objektiva kryesorë përmes të cilëve synohet transformimi i ekonomisë agro-rurale duke e bërë atë më gjithëpërfshirëse, produktive, të qëndrueshme dhe konkurrense në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.

Si rezultat i mbështetjes së vazhdueshme nga ana e MBPZhR-së, përmes politikave mbështetëse për rritje dhe zhvillim të sektorit dhe promovim të eksportit të produkteve bujqësore, eksporti ka shënuar rritje ndër vite, ku në vitin e fundit kjo vlerë arriti në 92.6 mil. €. apo 18.7% rritje. Ndërsa rritje ka shënuar edhe importi i produkteve bujqësore, ku në vitin e fundit vlera arriti në 965.6 mil. €. apo rritje për 26.2% krahasuar me vitin paraprak.



Si rezultat i mbështetjes së vazhdueshme nga ana e MBPZhR-së, përmes politikave mbështetëse për rritje dhe zhvillim të sektorit dhe promovim të eksportit të produkteve bujqësore, eksporti ka shënuar rritje ndër vite, ku në vitin e fundit kjo vlerë arriti në 92.6 mil. €. apo 18.7% rritje. Ndërsa rritje ka shënuar edhe importi i produkteve bujqësore, ku në vitin e fundit vlera arriti në 965.6 mil. €. apo rritje për 26.2% krahasuar me vitin paraprak.




Vlera e mbështetjes për këtë vit për Programin e Pagesave Direkte është 52 mil.€, ku është rritur përkrahja mbi 200% te kulturat strategjike, si: gruri, misri, patatja dhe fasulja, për të krijuar kështu mundësi stabiliteti sa i përket sigurisë ushqimore dhe të reflektojë tek mosrritja e çmimeve në treg.

Pjesëmarrja e eksportit të produkteve bujqësore në eksportin e përgjithshëm është 12.4%, përderisa pjesëmarrja e importit të produkteve bujqësore në importin e përgjithshëm është 20.8%. Bazuar në këto të dhëna, rezulton se ka rritje të vlerës së eksportit, por njëherazi ka edhe rritje të vlerës së importit dhe po ashtu thellim të mëdijshëm negativ të bilancit tregtar në 872.9 mil.€.

Duke parë gjendjen momentale me krizat globale dhe situatat e krijuara si pasojë e pandemisë me COVID 19, e cila tash e sa vite po na shoqëron, si dhe pengesat me sigurimin e fuqisë punëtore, ne jemi duke punuar që politikat tona t'i orientojmë në fushat ku vendi ka më shumë nevojë. Përmes programeve mbështetëse është duke u bërë përpjekje që të kemi stabilitet në çdo hallkë të ciklit të zinxhirit të prodhimit bujqësor, duke siguruar në vazhdimësi prodhim dhe furnizim.

Buxheti i shpenzuar i MBPZhR (2018-2021)



Burimi: Ministria e Bujqësisë, e Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural


Sa i përket dy programeve mbështetëse, vlera e mbështetjes për këtë vit për Programin e Pagesave Direkte është 52 mil.€, ku është rritur përkrahja mbi 200% të kulturat strategjike, si: gruri, misri, patatja dhe fasulja, për të krijuar kështu mundësi stabiliteti sa i përket sigurisë ushqimore dhe të reflektojë tek mosrritja e çmimeve në treg. Ndërsa, Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për këtë vit ka vlerën 26 mil.€ dhe përfshin 4 (katër) masa, që janë të orientuara në mbështetje të prodhimit primar, përpunimit, diversifikimit dhe zbatimit të qasjes "leader". Mbështetje më e madhe është ofruar në ngritjen e depove/pikave grumbulluese për pemë e perime si dhe dyfishim i buxhetit për diversifikim të aktiviteteve në zona rurale.

Vlen të ceket se buxheti i shpenzuar për sektorin e bujqësisë çdo vit ka shënuar rritje, dhe nëse e shikojmë trendin e viteve të fundit, mund të themi se ka pasur rritje të vazhdueshme, veçanërisht në vitet 2020 (69.7 mil.€) dhe 2021 (75.0 mil.€).

MBPZhR, rëndësi të veçantë gjatë këtij viti i ka kushtuar plotësim-ndryshimit dhe hartimit të legjislacionit, ku ka proceduar në Qeveri disa Projektligje të cilat janë miratuar. Gjithashtu është duke implementuar pakon për eliminimin e barrës administrative në kuadër të së cilës ofrohen mundësi lehtësimi të të bërit biznes dhe shkurtrim të procedurave administrative.

Ministria jonë mbetet e përkushtuar gjithnjë që të bashkëpunojë edhe me donatorë dhe përfaqësues të ndryshëm, të cilët kontribuojnë në fushën e bujqësisë e një ndër ta është edhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), ku MBPZhR-ja bashkëpunon ndër vite në shkëmbim të të dhënave statistikore dhe të analizave, të cilat mundësuan edhe zhvillimin e platformës "Agrosoft", që është një aset i rëndësishëm për ekonominë vendore dhe shërben për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë.





Me ndryshimet në Ligjin për FKGK, tani lejohej edhe garantimi i fermerëve që posedojnë Certifikatë të Fermerit dhe Numër Identifikues të Fermës (NIF).

*për periudhën Janar - Qershor 2022 dhe për bizneset e regjistruara në ARBK.



FINANCIMI I SEKTORIT TË BUJQËSISË PËRMES BANKËS EKONOMIKE

Banka Ekonomike si banka e vetme me kapital 100 % vendor, përveç mbështetjes së bizneseve në financimin e projekteve dhe të planeve të tyre investuese, fokusohet edhe në sektorin e bujqësisë, duke ofruar produkte të disenjuara në përputhshmëri të plotë me ndryshimet në treg, në mënyrë që të plotësojë dhe të përkrahë kërkesat e këtij sektori, si dhe rrjedhimisht të ndikojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik të vendit.

Në kategorinë e sektorit në fjalë banka përkrah financiarisht agrobizneset e regjistruara, fermerët individualë që posedojnë NIF (numër identifikues të fermerit) dhe ekonomitë e vogla bujqësore familjare.

Sektori i bujqësisë vazhdon të jetë një nga sektorët më të rëndësishëm për ekonominë e vendit, mirëpo në vazhdimësi po përballet me shumë sfida dhe vështirësi nga viti në vit.

Disa nga arsyet janë cekur më poshtë.

NEVOJA PËR INVESTIME DHE VËSHTIRËSITË FINANCIARE.

Investimet në këtë sektor janë mjaft të ulëta. Nga bilancet tregtare shihet që ne si vend varemi shumë nga importi dhe këto janë sinjale që të bëhet më shumë përpjekje për rritje të investimeve dhe prodhimit vendor në këtë sektor.

Mirëpo, nga ana tjetër, mundësia e fermerëve për të investuar me mjete vetanake është shumë e vogël, andaj është e nevojshme të ketë përkrahje më të madhe financiare nga Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural si dhe institucionet financiare.



BURIM BYTYÇI

Specialist për Agrobiznese
Banka Ekonomike



Banka Ekonomike si banka e vetme me kapital 100 % vendor, përveç mbështetjes së bizneseve në financimin e projekteve dhe të planeve të tyre investuese, fokusohet edhe në sektorin e bujqësisë, duke ofruar produkte të disenjuara në përputhshmëri të plotë me ndryshimet në treg.

- Fuqia punëtore - Sektori i bujqësisë viteve të fundit po ballafaqohet me një sfidë të vështirë, atë të fuqisë punëtore. Mungesa e fuqisë punëtore dëmton rëndë zhvillimin e këtij sektori dhe kjo po ndodh për disa arsye. Njëra ndër to është emigrimi jashtë vendit. Ka mjaft raste të ekonomive të vogla familjare në zona rurale që kanë pasur një aktivitet bujqësor të diversifikuar dhe janë marrë me kultivimin e disa kulturave të ndryshme bujqësore me sipërfaqe të vogla, të cilët i kanë ndërprerë plotësisht këto aktivitete bujqësore. Fermerë individualë me ferma të kafshëve me numër më të vogël të krerëve, kanë vendosur t'i mbyllin këto veprimtari duke i shuar si aktivitete bujqësore/blegtorale. Kjo për shkak të problemeve me të cilat ata ballafaqohen, si: fuqia punëtore, pasiguria, tregu etj., dhe mungesa e perspektivës në këtë drejtim, sipas tyre. Kjo situatë i bën që të shqyrtojnë mundësi të tjera, ku ndër kryesoret gjithmonë potencohet emigrimi ose punësimi me ndonjë pagë që u siguron të hyra të rregullta mujore.

- Kostoja e lartë e prodhimit: Fermerët në vazhdimësi hasin në pengesa për të përballuar kostot e larta për prodhimin e kulturave të ndryshme bujqësore. Me rritjen e çmimeve gjatë vitit të fundit, fermerët janë përballur me çmime mjaft të larta të inputeve bujqësore, farërave, plehrave, fidanëve, materialeve të tjera të nevojshme gjatë procesit të kultivimit, preparateve për trajtime të bimëve, për mbrojtjen dhe ushqimin e tyre, derivateve etj. Njëherit edhe në shërbimet bujqësore ka pasur rritje të çmimeve si rezultat i çmimit të derivateve, të cilat kanë ndikuar direkt në rritje të kostos së përpunimit të tokës, përgatitjes për mbjellje fillimisht, e më pas trajtimet e nevojshme deri në korrje ose vjelje të produkteve.

Në shërbimet bujqësore që përfshijnë pjesë të mekanizmit bujqësor, shumë fermerë nuk kanë mundësi të posedojnë gjithë mekanizmin që i nevojitet për arsyeje të çmimit të lartë, prandaj për punë të caktuara detyrohen të paguajnë shërbime nga ndonjë fermer ose person tjetër që i posedon ato makineri, dhe normalisht, kjo e rrit koston e prodhimit.

- Rrezikshmëria: Sektori i bujqësisë ka ndjeshmëri të lartë për arsye të kushteve atmosferike. Prodhimet bujqësore varen shumë nga kjo pjesë dhe kjo ndikon direkt në rendimentin e produkteve. Nëse fermerët mund të kalkulojnë saktë se sa është kostoja për mbjelljen e një kulture të caktuar, të njëjtit nuk janë në dijeni sa do të jetë rendimenti i produktit dhe çfarë cilësie do ketë produkti, kjo për arsye të kushteve atmosferike, reshjeve të shumta, thatësirës së madhe, reshjeve të breshërit etj. Kushtet jo të mira atmosferike gjatë vitit ndikojnë që rendimenti të mos jetë ai që është planifikuar dhe kjo ka impakt direkt edhe tek të hyrat që fermerët kanë planifikuar të realizojnë përmes shitjes.

Viteve të fundit ka interesim edhe nga kompanitë e sigurimeve që të jenë pjesë e bashkëpunimit për sigurime bujqësore për disa kultura që do të lehtësonte sadopak pjesën e shpenzimeve të fermerit në rast të dëmtimit nga kushtet atmosferike. Ministria e bujqësisë krahas përkrahjes përmes subvencioneve dhe granteve bujqësore ka marrë përsipër të stimulojë këtë nismë me pagesën e primit të sigurimit me një % të caktuar si ndihmesë për fermerët.

- Tregu për produktet bujqësore – Shitja e produkteve bujqësore është fazë mjaft e rëndësishme për fermerin pasi pret benefitet e punës së tij dhe kjo i ka sfidat e veta. Fillimisht disa produkte bujqësore kanë jetëgjatësi dhe qëndrueshmëri të shkurtër dhe, nëse nuk shiten me kohë fillojnë ta humbasin cilësinë. Krijimi i kushteve me depo dhe dhoma frigoriferike për ruajtje më të gjatë të produkteve bujqësore kanë kosto të lartë dhe vetëm disa bujq me sasi më të mëdha prodhimi investojnë në ndërtimin e tyre. Një shqetësim tjetër për fermerët dhe bujqit në përgjithësi është edhe konkurrenca nga produktet e importit, të cilat janë mjaft konkurruese me çmime dhe u shfaqin vështirësi fermerëve vendorë. Sa i përket tregtisë, nga të dhënat për produktet bujqësore shihet se kemi një bilanc tregtar të atillë që vetëm 10.2% e mbulohet importi me eksport. Ka deficit tregtar dhe mjaft hapësirë për ta stimuluar dhe rritur produktin vendor, qoftë për

konsum të brendshëm apo edhe për eksport, mirëpo kërkohet përkrahje më e madhe në këtë drejtim.

Duke parë nevojat dhe kërkesat e tregut, Banka Ekonomike në vazhdimësi është përpjekur që t'u përgjigjet këtyre kërkesave në mënyrën më adekuate. Profilizimi i produkteve, në veçanti i produktit të agrokredive, ka kontribuar në ofrimin e mundësisë që ky produkt të avancojë edhe më shumë në të ardhmen. Produkti i agrokredisë, si produkt i veçantë, ka ndikuar në profilizimin e stafit i cili u përgjigjet më së miri kërkesave specifike që mund të ketë ky produkt. Aktualisht, stafi ynë i specializuar për agrokredi mbulon të gjitha regjionet, duke qenë sa më afër klientit.

- Banka Ekonomike vazhdon të jetë e angazhuar në mbështetjen e këtij sektori, duke u mundësuar fermerëve kredi me qasje të lehtë dhe të shpejtë, me ç' rast ndihmojmë në rritjen e kapaciteteve prodhuese, përpunuese dhe rritjen e aktiviteteve bujqësore, blegtorale tek fermerët. Kthimin e kredive banka e mundëson sipas kërkesave të klientëve me plane të rregullta, plane jo të rregullta dhe me grejs periudhë deri në një vit, duke u bazuar në të hyrat e tyre dhe duke iu përshtatur sezonalitetit për aktivitete ose veprimtari me të cilat klientët merren. Banka po ashtu ka lansuar kampanja atraktive në periudha të caktuara të vitit me qëllim të rritjes së financimit në bujqësi.

Banka Ekonomike

AGRO KREDI

deri në **30,000€**

Me beneqet!

- PA HIPOTEKË
- Mundësi pa garantues
- / pa bashkëhuamarrës
- Kushte preferenciale
- Grejs periudhë

Rol të rëndësishëm në financimin e këtij sektori ka luajtur edhe Fondi për Garanci Kreditorë të Kosovës (FKGK), i cili ka lehtësuar financimin nga ana e bankës për ata klientë të cilët kanë hasur vështirësi në sigurimin e kolateralit të mjaftueshëm sipas politikave dhe procedurave të bankës.

Po ashtu krijimi i platformës "Agrosoft" dhe trajnimi i stafit nga ana e Fondit për përdorimin e saj ka qenë një lehtësim mjaft i madh. Kjo platformë siguron mjaftueshëm të dhëna dhe informacionet e fundit për ngjarjet që ndodhin në këtë sektor. Të dhënat përditësohen në vazhdimësi për kulturat e ndryshme dhe me lajmet e fundit që kanë të bëjnë me bujqësinë në përgjithësi. Banka synon që të vazhdojë edhe më tutje bashkëpunimin me FKGK-në për rritjen e financimit në sektorin e bujqësisë.

Në vazhdimësi, fokusi ynë është në ofrimin e shërbimeve cilësore e adekuate për klientët tanë, duke vendosur në plan të parë kërkesat e klientit dhe duke dëshmuar profesionalizëm dhe përgjegjshmëri në shërbimet që ofrojmë, fokusi ynë mbetet i njëjtë edhe në vijim, duke synuar vazhdimësi të një afarizmi të suksesshëm.

Banka Ekonomike mendon për ju.

MENDO SIVJET PËR INVESTIMET E PRANVERËS!

AGRO KREDI 50,000€

Kredi për **Agro Biznese** deri në **50,000€**
Pa hipotekë dhe deri në 12 muaj grejs periudhë!

20 VITE BASHKËPUNIMET
Banka Ekonomike

KREDITIMI NË BUJQËSI SI PRIORITET I KEP TRUST

Duke u nisur edhe nga ngjarjet e fundit globale, mund të arrijmë në konkludimin tashmë veçse të ditur që nga ekzistenca e vetë njerëzimit se bujqësia është në fakt vetë ekzistenca e njeriut. Ngrohja globale e cila është shpejtuar në dekadën e fundit dhe rritja e madhe e popullsisë në botë e ka sjellë në disproporcion të shtuar raportin në mes të kapaciteteve prodhuese bujqësore dhe kërkesës për ushqim në nivel global.

Gjithashtu, lufta e fundit në Ukrainë ka treguar se sa e nevojshme dhe sa fundamentale është për një vend që të ketë prodhimin vendor dhe të arrijë që mjaftueshëm t'i mbulojë nevojat e veta. Pamundësia që Ukraina të nxjerrë jashtë vendit prodhimet e veta bujqësore (grurë, drithëra, -12% e tregëtisë botërore; luledielli, 50% e eksporteve botërore etj.) ka ndikuar mjaft shumë që të ketë mungesë të madhe në treg të produkteve bazike ushqimore dhe, rrjedhimisht edhe rritje enorme të çmimeve në treg.

Bujqësia është degë shumë e rëndësishme e ekonomisë së një vendi, që ndikon shumë në zhvillimin ekonomik dhe është promotor edhe në krijimin e vendeve të reja të punës.

Kosova ka një klimë dhe pozitë të përshtatshme për aktivitetet bujqësore, varësisht nga zona ku ushtrohet aktiviteti. Rritja e aktivitetit bujqësor është e lidhur ngushtë edhe me qasjen në financa dhe në kreditim, e këtu padyshim se KEP Trust ka një ndikim pozitiv, sepse që nga themelimi në vitin 1999 vazhdon ta ketë prioritet financimin e aktiviteteve bujqësore. Gjatë dy dekadave të operimit në Kosovë, janë shërbyer mijëra klientë dhe aktivitete bujqësore, dhe kështu janë përkrahur fermerët në rritjen e kapaciteteve dhe krijimin e vendeve të reja të punës. KEP Trust sot ofron kredi bujqësore për të gjitha nevojat e fermerëve: për të blerë inpute bujqësore, asete fikse, makineri



MUHARREM KRASNIQI
Kryesues i njësisë së Agro kredive

bujqësore dhe investime të ndryshme sipas nevojave të agro biznesit. Portfoli i kredive bujqësore në KEP Trust është gjithënjë në rritje, dhe tani është në nivelin 18% të portfolit total.



Rritja e aktivitetit bujqësor është e lidhur ngushtë edhe me qasjen në financa dhe në kreditim, e këtu padyshim se KEP Trust ka një ndikim pozitiv, sepse që nga themelimi në vitin 1999 vazhdon ta ketë prioritet financimin e aktiviteteve bujqësore.

KEP Trust gjithnjë është afër fermerëve dhe nevojave të tyre, dhe stafi ynë është i përkushtuar maksimalisht që të ndihmojë ata gjatë financimit të tyre me asistencë dhe këshilla profesionale, si dhe me korrektësi e seriozitet maksimal.

Me qëllim të rritjes së kreditimit në bujqësi, KEP Trust ofron norma interesi mjaft atraktive për kreditë bujqësore, norma të cilat janë më të ulëta krahasuar me produktet e tjera që ofron KEP. Ky është treguesi më i mirë për përkushtimin e KEP Trust në zhvillimin e bujqësisë dhe rrjedhimisht ngritjen ekonomike të vendit. KEP Trust ka disenjuar produkte mjaft të përshtatshme për nevojat e fermerëve duke ofruar plane të pagesave fleksibile dhe duke iu përshtatur nevojave të agrobiznesit varësisht nga natyra e aktivitetit bujqësor.

MISIONI SOCIAL

Me qëllim të mbështetjes së bujqësisë dhe rritjes së kapaciteteve të fermerëve, institucioni përmes bashkëpunimeve me partnerë të ndryshëm, në vazhdimësi organizon trajnime të ndryshme me fermerë. Ideja është që përmes këtyre takimeve të arrihet ngritja e njohurive dhe e kapaciteteve të fermerëve tanë, si dhe shkëmbimi i praktikave sa më të mira në bujqësi.


Në kuadër të përgjegjësisë sociale korporative, KEP Trust ka financuar zhvillimin e platformës www.agroportal-ks.com, e cila shërben si dritare informative dhe edukative për fermerë.

“AgroPortali” ka përmbajtje unike dhe dinamike mbi praktikën e mirë bujqësore të prezantuara shkurt dhe qartë, për të tërhequr vëmendjen e të gjitha gjeneratave të fermerëve, rrjedhimisht për të gjithë ata që dëshirojnë të mësojnë më tepër rreth prodhimit bujqësor dhe agrobiznesit.

Qëllimi i “Agroportalit” është përmirësimi i qasjes në informata dhe forcimi i komunikimit midis agrobizneseve dhe komunitetit bujqësor në tërësi. Struktura dhe aktivitetet e “AgroPortalit” do të përqendrohen në zinxhirët më të rëndësishëm të vlerave të sektorit të bujqësisë dhe shërbimeve bujqësore, duke ofruar një platformë për: bujqësi, blegtori, mbrojtje të ambientit, agroekonomi, turizëm rural, inovacion dhe teknologji.

KEP Trust edhe në vitet në vazhdim do të jetë afër fermerëve dhe do të përpiqet që me produkte sa më atraktive të lehtësojë rrugën e klientëve drejt suksesit.





FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

TË ARRITURAT DERI MË 30 SHTATOR 2022



VE-TRO-ISOL AG Sh.pk. GO HEALTHY

Rruga për në Ferizaj gjithmonë është e këndshme, sepse sa herë shkojmë atje, diçka ka ndryshuar: biznese të reja, ndërtime, investime etj. Pra, të krijohet ndjesia që këtu punohet shumë. Kësaj radhe vizitua një biznes të veçantë, pikërisht në këtë qytet.

VE-TRO-ISOL AG Shpk është biznesi që vizitua e ku u pritëm ngrohtësisht nga pronari z. Skyfter Ajvazi. Era e kamomilit, e blirit, e frutave të ndryshme që grumbullohen aty e që pastaj thahen e konservohen, për t'u përgatitur për eksport, ndihej kudo.

"Çajra të ndryshme të tokës së Kosovës i mbledhin vendasit dhe i sjellin këtu të freskëta, produkte për të cilat ne përkujdesemi për t'i tharë e konservuar, gjithnjë natyrale e 100% bio dhe organike, të cilat i eksportojmë kryesisht në Itali", na tha z. Ajvazi.

Motoja e biznesit tonë është të kemi produkt cilësor dhe organik, që klienti të shijojë aromën e çajit të vërtetë, e që ne i kemi 9 lloje të ndryshme: çaj nga fruta mali; çaj mente; çaj bliri; i gjelbër; mollë e egër; kamomil; hibiskus dhe kaçë, si dhe nga portokalli, limoni e xhenxhefili. Gjithashtu, këtu bëhet tharja e kërpudhave, nga llojet e veçanta: porcini dhe chanterelle." - tha z. Ajvazi.

VE-TRO-ISOL AG Shpk ka punësuar tetë punëtorë të rregullt, si dhe çdo vit, varësisht nga nevoja, punëson 20-50 punëtorë sezonalë që mbledhin e grumbullojnë çaj e fruta të ndryshme. Këtu, punëtorët janë aseti kryesor duke u ofruar kushte të mira si punëdhënës.

Bizneset në Kosovë ballafaqohen me sfidën e likuiditetit; shpeshherë është sfidues grumbullimi i borxheve. Prandaj, kreditë na ndihmojnë e lehtësojnë qasjen në financa kurdo që na duhet investim për të bërë.

Me kredinë e fundit të garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, ne kemi investuar në blerjen e produkteve, të cilat pastaj i kemi përpunuar dhe kemi plotësuar kërkesën që kemi për eksport. Kësisoj, kemi arritur që të eksportojmë rreth 200 tonë produkte në vit!

Marka/brendi "Go Healthy", si pjesë e biznesit VE-TRO-ISOL AG Shpk, është treguar një markë e veçantë, e cila është pozicionuar në tregun tonë dhe jashtë saj, si markë që ofron cilësinë e garantuar.



FKGK SHËNON GJASHTË VJETORIN E THEMELIMIT - JAVA E FONDIT

Maj 2022 - U shënua java e FKGK-së me rastin e 6-vjetorit të themelimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë. U organizuan disa aktivitete gjatë javës së dytë të muajit maj: Ligjërata në UP; Intervistë në Radio Kosovë; "Brunch" për bashkëpunëtorë. Është bërë traditë e FKGK-së që të iniciojë aktivitetin e mbjelljes së drunjve me qëllim të krijimit të hapësirave të gjelbra. Me këtë rast, stafi i FKGK-së i mbolli dymbëdhjetë drunj bliri në oborrin e Shkollës së Mesme Ekonomike në Fushë Kosovës, në koordinim me Komunën e Fushë Kosovës.



FKGK PREZANTOHET NË INTERVISTËN E INDEP

Maj 2022 – FKGK-ja, është bërë pjesë e intervistës së organizuar nga INDEP, për të diskutuar mbi zbatimin e "Pakos së Ringjalljes". Si vazhdim i aktiviteteve të cilat mëtojnë të ngrisin vetëdijen rreth "Pakos së Ringjalljes Ekonomike", të aprovuar në korrik të vitit 2021, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ftoi në diskutimin e radhës, Drejtorin Menaxhues të Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë, z. Besnik Berisha.



FKGK PJESE E BULETINIT TË KËSHILLIT TË INVESTITORËVE EVROPIANË - EIC

Qershor 2022 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore u prezantua në buletin e Këshilli i Investitorëve Evropianë – EIC. Në këtë edicion mujor u intervistua drejtori menagjues i FKGK-së i cili shpjegoi veprimtarinë e këtij institucioni, rolin që ka luajtur në mbështetjen e MSME-ve përgjatë sfidave të shumta financiare të krijuara veçanërisht pas shpërthimit të pandemisë COVID-19, si dhe perspektivat e tij për të ardhmen.

FIRST SESSION:
ZERO POLLUTION - WHO PAYS THE PRICE FOR POLLUTION?

“

A green agenda is not something which is colorful. It is black and white! Either we do it all, or we don't do it. This means a lot of, if I can say consequences in the short term for the ordinary citizens of our country, for the private sector, for the public sector and for the overall state.



Besnik Berisha,
Managing Director of Kosovo Credit Guarantee Fund
Event Moderator

LANSOHET DRITARJA GROW



17 qershor 2022 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) dhe partnerët lansuan dritaren e re të garancioneve bankare GROW – Dritarja e Rimëkëmbjes së Gjellbër, e cila do të mbështesë investimet e bizneseve kosovare në energji të ripërtërishme dhe eficientë të energjisë. Projekti GROW i disenuar dhe financuar nga Fondacioni i Milleniumit i Kosovës (MFK) dhe i përkrahur nga Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC), hapi sot fazën e dytë të projektit. Falë kapitalit prej 6 milionë eurosh të donuara nga Qeveria Gjermane përmes Bankës Gjermane për Zhvillim KfW, dhe garancioneve shtesë të lëshuara nga agjencioni federal amerikan DFC, dritarja e re e implementuar nga FKGK-ja do t'i ndihmojë institucionet partnere financiare në kreditimin e sektorëve të cilët nuk janë shërbyer deri më tani. Si pjesë e fazës pilot, gjatë ceremonisë së lansimit të dritares, u nënshkrua marrëveshja me bankën ProCredit, si partneri i parë financiar i cili do të ofrojë këtë lloj shërbimi për klientët e tij. Së shpejti do të vijojë bashkëpunimi me institucione të tjera financiare në Kosovë. Me këtë rast drejtori i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, z. Besnik Berisha, deklaroi se: “Misioni i Fondit Kosovar për Garanci Kreditore është lehtësimi i qasjes në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme. Në rastin konkret “Dritarja e Rimëkëmbjes dhe Mundësive të Gjellbërta” do të mbështesë fuqizimin e investimeve në këtë drejtim, gjë që është thelbësore për një zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe rritjen e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve kosovare.

FKGK PUBLIKON DOKUMENTARIN PËR START-UP

15 Korrik 2022 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore publikoi dokumentarin për bizneset "StartUp". Cilat janë programet që ofrohen për "StartUp" në Kosovë? Çfarë mbështetje kanë ndërmarrësit e rinj? Me çfarë sfida ballafaqohen ata? A kanë qasje në financa? Pjesë të dokumentarit ishin përfaqësues nga banka TEB ShA si dhe Venture UP të cilët kontribuan në realizimin e dokumentarit, si dhe përfaqësuesja e FKGK-së, znj. Nora Arifi.

FKGK PJESË E FORUMIT TË SOLARËVE 2022

21 Korrik 2022 – FKGK-ja prezantohet në Forumin e solarëve në Kosovë #GROW #KCGF Besnik Berisha #kosvosolarforum



FKGK PUBLIKON RAPORTIN VJETOR 2021



NËNSHKRUHET MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT PËR DRITAREN E EKSPORTIT

20 Gusht 2022 – USAID
#KosovoCompete dhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, së bashku do të krijojnë dritaren e eksportit, një dritare e re garantuese që do të përkrahë qasjen në financa për eksportuesit kosovarë. Ky është një hap i madh i prezantimit të formave të reja të financimit në sektorin privat.



DELEGACIONI I FKGK-SË NË TAKIMIN E PËRGJITHSHËM TË AECM-SË

14-17 Shtator – Ekipi përfaqësues i FKGK-së i përbërë nga: Rinor Gjonbalaj-Kryesues i Bordit, Besnik Berisha- Drejtor Menaxhues dhe Vjosa Balaj- Menaxhere e Lartë e Financave, ishin pjesëmarrës në ngjarjen më të madhe vjetore të AECM-Shoqata Evropiane e Institucioneve Garantuese në Vjenë. Fokusi i këtij viti ishte financimi i qëndrueshëm për #NVM-të dhe #Startup-ët. FKGK-ja u prezantua nga Drejtori Menaxhues në panelin e titulluar "Të bëjmë NVM-të të përshtatshme për të ardhmen".





FONDOS KOSOVAR PER GARANCI
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE





FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

Buletin i FKGK-së

EDICIONI I PESTË | Tetor 2022

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

Adresa:
Njazi Alishani Nr. 5,
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0) 38 225 600
info@fondikgk.org

www.fondikgk.org